



Buletini informativ # 4 – maj-qershor 2013

- Seanca e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (PShDNj)
- Shkeljet e të drejtave të njeriut në lëndët e *Vidovdanit*
- Takimi me Panelin Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut të UNMIK-ut (PKDNj)
- Prezantimi për prokurorët ndërkombëtar të EULEX-it
- Fushata informuese

Seanca e PShDNj

Seanca e gjashtëmbëdhjetë (16-të) e rregullt e PShDNj-së është mbajtur në Prishtinë nga data 5 deri më 7 qershor 2013. Paneli ka shqyrtuar nëntë (9) ankesa. Në fillim të seancës kanë qenë tetëmbëdhjetë (18) ankesa të papërfunduara pranë Panelit.

Shkeljet e të drejtave të njeriut

PShDNj-ja ka deklaruar se ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut nga EULEX-i gjatë kryerjes së mandatit ekzekutiv në lidhje me [katër lëndë](#) të cilat kanë ndodhur në *Vidovdan* më 28 qershor 2012. Festa e *Vidovdanit* shënon një festë të rëndësishme fetare në të cilën mijëra serb etnik vizitojnë vendet përkujtimore në Kosovë. Katër ankues kanë pohuar se ishin objekt i sulmeve nga palë të paidentifikuara private, të cilët përfshijnë, ndër të tjera, hedhjen e gurëve dhe koktejtve të molotovit drejt adoleshentëve serbë të cilët po udhëtonin me autobus nga Gazimestani në Graçanicë pas festimeve të *Vidovdanit*. Një tjetër ankues ka pohuar se ai ishte sulmuar nga Policia e Kosovës. PShDNj-ja ka konstatuar se pamjaftueshmëria e caktimit të burimeve nga ana e EULEX-it gjatë operacionit të tij të sigurisë në atë ditë kishte kontribuar që ankuesve t'ju mohohesh plotësisht dhe në mënyrë efektive gëzimi i të drejtës për jetë private, lirisë e tyre për tubim, si dhe të drejtës së tyre për ta ushtruar religjionin e tyre në mënyrë të sigurt dhe pa pengesë të panevojshme. Për më tepër, PShDNj-ja ka konkluduar se EULEX-i nuk ka arritur të tregoj se e kishte kryer një hetim të plotë dhe të përshtatshëm rreth shkeljeve të pohuara të të drejtave të njeriut. Si rezultat, ankuesve ju ishte mohua mjeti i përshtatshëm juridik. Paneli gjithashtu ka rekomanduar që të miratohen një sërë masash korrigjuese nga shefi i misionit për të adresuar çështjet në fjalë.

Vendimet

PShDNj-ja ka gjetur [një ankesë e pranueshme](#) në lidhje me shkeljen e pretenduar të të drejtave të njeriut, si pasojë e një veprimi të papërshtatshëm të supozuar nga një anëtar ndërkombëtar i personelit të EULEX-it ndaj një zyrtareje të policisë së Kosovës. PShDNj-ja ka deklaruar gjithashtu [një lëndë tjetër si të papranueshme](#). Kjo lëndë ka të bëjë me një kontest pune ndërmjet ankuesit dhe ish punëdhënësit të tij, Korporatës Energjetike të Kosovës. Më tej Paneli ka vendosur që t'i komunikoj këto dy lëndë të tjera te shefi i misionit për vërejtje.

Takimi me Panelin Këshillëdhënës të të Drejtave të Njeriut të UNMIK-ut (PKDNj)

Më 5 qershor 2013, PShDNj-ja është takuar me organizatën simotër, Panelin Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (PKDNj) i Misionit të Përkohshëm të Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) në selinë e UNMIK-ut. Panelet kanë krahasuar përvojat e ndërsjella profesionale të deritanishme, kanë diskutuan çështje të interesit të përbashkët dhe kanë reflektuar mbi sfidat e së ardhmes.

PKDNj-ja dhe PShDNj-ja përfaqësojnë një zhvillim të ri themelor në të drejtën ndërkombëtar për të drejtat e njeriut pasi që të dy Panelet janë organet e para të institucionalizuar ndonjëherë të angazhuara për vlerësimin e shkeljeve të pretenduara të drejtave të njeriut nga ana e organizatave ndërkombëtare në kryerjen e kompetencave ekzekutive në misione paqeruajtëse dhe përkatësisht sundimin e ligjit.



Nga e majta në të djathtë: Andrey Antonov, Marek Antoni-Nowicki (kryesues i PKDNj-së), Christine Chinkin, Françoise Tulkens (PKDNj), John J Ryan, Guénaél Mettraux, Elka Filcheva-Ermenkova, Magda Mierzewska, (kryesuese e PShDNj-së) dhe Katja Dominik (PShDNj).

Prezantimi i Panelit për prokurorët

Paneli me ftesë të znj. Jaroslava Novotna, zëvendëse shefe e divizionit ekzekutiv dhe kryeprokurore e EULEX-it, ka bërë një prezantim për prokurorët ndërkombëtarë të EULEX-it dhe zyrtarët ligjorë më 6 qershor 2013 lidhur me mandatin, operacionet e tij dhe procedurat. Paneli dhe pjesëmarrësit u përshëndetën nga z. Mats Mattsson, shef i divizionit ekzekutiv të EULEX-it, i cili hapi seancën. Prezantimi u pasua nga një diskutim mbi juridiksionin dhe jurisprudencën e PShDNj-së me një theks të veçantë mbi ankesat që janë parashtruar në Panel dhe që lidhen me vendimet dhe aktet e prokurorëve të EULEX-it.



Prezantimi në auditoriumin e EULEX-it (nga e majta në të djathtë) Elka Filcheva-Ermenkova, Magda Mierzewska (kryesuese), Guénaél Mettraux.

Paneli ka përpunuar një tabelë të jurisprudencës, ku përmbledhen shumë çështje që lidhen me juridiksionin e vet, çështje procedurale si dhe me meritat e rasteve. Tabelën mund ta shihni përmes faqes së internetit të Panelin në www.hrrp.eu/jurisprudence.php

Fushata publike informuese

PShDNj-ja përsërit shqetësimin e tij për mungesën e vazhdueshme të njohurive lidhur me ekzistencën dhe mandatin e tij, pavarësisht prej përpjekjeve të tij më të mira dhe të vazhdueshme deri më tani për të zhvilluar fushatën e tij informuese në terren. Ekziston një nevojë urgjente për të rritur ndërgjegjësimin e publikut për rolin e tij korrigjues si një mekanizëm llogaridhënës për shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv.

Sekretariati ka vazhduar fushatën e tij me takime në Gjilan, Pejë, Prizren, Mitrovicë dhe Kamenicë gjatë së cilës Sekretariati i PShDNj-së ka takuar dhe ka njoftuar homologët e tij, siç janë OJQ-të për të drejtat e njeriut, zyrtarë publikë/institucional, përfaqësues fetar, institucione arsimore dhe organizata ndërkombëtare siç janë OSBE-ja, Këshilli i Evropës, dhe UNMIK-u. Sekretariati gjithashtu ka vazhduar me fushatën e tij në terren në Prishtinë ku është takuar, ndër të tjera, me përfaqësuesit e Qendrës Juridike të Kosovës, Rrjeti Strategjik Aksional Kosovar dhe me famullitarin e Kishës Katolike Romake në Kosovë.



Nga e majta në të djathtë: John J. Ryan, Don Lush Gjergji (famullitar, Kisha katolike romake në Kosovë), Joanna Marszalik

Statistikat rreth lëndëve - qershor



PARASHTRIMI I ANKESAVE

(Rregullat 25 dhe 26 të Rregullores së punës të PShDNj-së)

Kush?

Çdo person i cili nuk punon për misionin e EULEX-it në Kosovë, dhe i cili ankohet se ka qenë viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut nga ana e misionit të EULEX-it në Kosovë gjatë zbatimit të mandatit ekzekutiv të tij.

Ankuesi (personi që e bën ankesën) mund të përfaqësohet nga ndonjë avokat ose përfaqësues tjetër sipas dëshirës së tij ose saj. Në këtë rast duhet të plotësohet autorizimi.

Çka?

Paneli do t'i shqyrtojë vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me këto shkelje të pohuara e të cilat kanë ndodhur në Kosovë pas datës 9 dhjetor 2008. Shkelja duhet të jetë shkaktuar nga misioni i EULEX-it në Kosovë gjatë zbatimit të mandatit ekzekutiv të tij.

Paneli nuk do t'i shqyrtojë procedurat gjyqësore të kryera nga gjykatat në Kosovë.

Kur?

Ankesa duhet t'i parashtrohet Panelit para datës 9 shtator 2010 ose brenda gjashtë muajve nga data e shkeljes së pohuar.

Si?

Ankesa duhet të paraqitet me shkrim. Ankesa nuk mund të bëhet me telefon. Ankuesi mund ta përdorë gjuhën angleze, shqipe ose serbe.

Normalisht, ankesa duhet të bëhet në formularin përkatës dhe të shoqërohet me dokumente dhe vendime përkatëse (nëse ka), sipas udhëzimeve në formular.

Nëse ankesa paraqitet me anë të letrës, në të duhet të përcaktohet, të paktën në formë të përmbledhur, lënda e ankesës në mënyrë që ajo të shqyrtohet më tej.

Ku?

Ankesa mund të parashtrohet në

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut - Sekretariati

Rruga: Rrustem Statovci nr. 29 – 10000 Prishtinë – Kosovë

Tel: +381 (0) 38 78 2125

Ankesa gjithashtu mund të parashtrohet përmes postës elektronike në: office@hrrp.eu

www.hrrp.eu

Plotësimi i formularit për ankesë

Ankesa duhet të shkruhet qartë dhe lexueshëm, dhe mundësisht të jetë e shtypur me kompjuter. Formulari duhet t'i përfshijë të gjitha hollësitë e nevojshme për ta kontaktuar ankuesin, nëse ka nevojë.

Nëse ankesa përmban fakte të dokumentuara, duhet të paraqiten kopjet e lexueshme. **Mos i dërgoni dokumentet origjinale.**

Dokumentet duhet të renditen sipas datës dhe të shënohen me numra rendor të njëpasnjëshëm, si dhe të jepet një përshkrim i shkurtë (p.sh. letër, urdhër, vendim, ankesë, etj.).

Ankesës i caktohet numri i dosjes. Numri i dosjes duhet të përmendet në të gjitha korrespondencat vijuese. Nëse ankuesi tashmë e ka një ankesë, e cila është duke u shqyrtuar nga Paneli, ai ose ajo duhet ta informojë Panelin lidhur me numrin e dosjes së mëparshme. Nëse ankuesi për arsye të ndryshme nuk dëshiron që identiteti i tij ose saj të bëhet publik, ai ose ajo duhet ta plotësojë pjesën përkatëse në formularin e ankesës.